30. Dosje Pune dhe Personale nr 2138, me 40( dyzetë) dhe 7(shtatë) fletë, në ngarkim të shtetasit **N.Sh.**, me pseudonimin “Ardiani”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

## **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 18, datë 18.09.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 18, datë 18.09.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Dosje Personale dhe Pune nr. 1954 me 364 (treqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Pseudonimi “Mileja” në ngarkim të **K.M.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. Dosje Personale dhe Pune nr 677 me 321 (treqind e njëzetë e një) fletë. Pseudonimi “Besniku” në ngarkim të **H.A.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Regjistër i dosjeve të objektit, drejtimit, kërkimit, fashikujt e të huajve dhe emigrantëve, dosjet e përgjithshme të informatave, nr. 01-1, datë 15.01.1975, model 9, me 99( nëntëdhjetë e nëntë) fletë.
4. Libër i evidencës operative nr. 1196, datë 02.02.1988, me 224 (dyqind e njëzetë e katër) fletë, i Punëtorit Operativ **V.E.**
5. Libri i dorëzimit të informatave nr. 5, viti 1984, me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë.
6. Regjistri alfabetik i këshillimeve dhe demaskimeve (model 7), me 98 ((nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret” .
7. Dosje përpunimi nr. 896, në ngarkim të **A.D.**, 55(pesëdhjetë e pesë) fletë, kategoria 2/B. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Dosje përpunimi nr. 1320, në ngarkim të **A.H.**, kategoria 2/B, me 27 (njëzetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. Dosje Personale dhe Pune nr 3012 ,me 30 ( tridhjetë) dhe 24 (njëzetë e katër) fletë, në ngarkim të shtetasit **I.B** , pseudonimi “Berisha”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret” .
10. Dosje Personale dhe pune nr 4506, me 27 (njëzet e shtatë) dhe 39 (tridhjetë e nëntë) fletë, në ngarkim të **V.K.**, pseudonimi “ Radisti”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
11. Libër i evidencës midis punëtorëve operativ, me 227 fletë, në ngarkim të Punëtorit Operativ **Gj.L.**
12. Libri i dorëzimeve të informatave nr. 32, 96( nëntëdhjetë e gjashtë) fletë.
13. Libri i dorëzimit të dokumenteve model 8, nr. 77 me 98( nëntëdhjetë e tetë) fletë.
14. Dosje fomulare nr. 5696, në ngarkim të **S.P.**, 38 fletë, kategoria 2/B. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

15. Dosje formulare nr. 4956, në ngarkim të **S.Gj**, 92( nëntëdhjetë e dy) fletë, kategoria 2/A. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
16. Regjistër alfabetik i informatave model 5, nr. 37 me 198(njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë.
17. Regjistri i dosjeve dhe fashikujve model 9, nr. 41, datë 7.3.1889, 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë.
18. Regjistër i këshillimeve dhe demaskimeve nr. 4, datë 20.07.1976, 196 fletë.
19. Fondi ish Dega e Puneve te Brendshme Kruje, dosja me titull "Procesverbale asgjesimit 1989, te dhenave ne dosjet e informatave". Kjo dosje ka 15 flete, me nivel klasifikimi "sekret". Dokumentet brenda kesaj dosje datojne nga 18.2.1989 deri me 11.11.1989.

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 19, datë 19.09.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "*Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"*", i ndryshuar", kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "*Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"*", kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit "*Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH"*", ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me vendimin nr. 19, datë 19.09.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Dosje Personale dhe Pune nr. 1178/1 me 619 (gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë ) fletë, në ngarkim të **Q.G**. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
2. Kartel Model 2, në emër të shtetasit **H.A**, kategoria A.
3. Kartel Model 2, nr. 847, në emër të shtetasit **R.M**, kategoria A.
4. Shkresa nr 99 Prot, datë 08.08.2019 me lëndën "Përgjigje e shkresës për zbardhjen e pseudonimeve të bashkëpunëtorëve, kërkuar nga shtetasi Jozef Radi në cilësinë e studiuesit", drejtuar Kryetares, Anëtarëve të Autoritetit dhe Drejtorisë së Informacionit.

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

## **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 20, datë 19.09.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 20, datë 19.09.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. **Fondi 4, Viti 1945, Dosja nr. 35**, “Raporte të personelit të Misionit Ushtarak dhe të UNRRA dërguar eprorve dhe instancave më të larta”. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.(18 fletë)
2. **Fondi 4, Viti 1958, Dosja nr. 108**, “Relacion mbi riardhësimet e emigracionit ekonomik e politik në Shqipëri”. Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.(7 fletë)
3. **Fondi 4, Viti 1944, Dosja nr. 12**, “Raporte informative të misionit ushtarak dhe të UNRRA dhe veprimtaris së tyre në Shqipëri”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”.(78 fletë)
4. **Fondi 4, Viti 1983, Dosja nr. 200**, “Raporte për L. B dhe vëllan e saj , A. B”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”.(4 fletë)
5. **Fondi 4, Viti 1977, Dosja nr. 235**, “L. B” Niveli i klasifikimit është “Sekret”.(3 fletë)
6. **Fondi 4, Viti 1961, Dosja nr.80**, “Relacione mbi L. B , Z. M etj . Niveli i klasifikimit është “Tepër sekret”.(10 fletë)
7. **Fondi 4, Viti 1987, Dosja nr. 242**, “M. Ç dhe L. B” Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (12 fletë)
8. **Fondi 4, Viti 1990, Dosja nr. 688**, “Informacione të dala nga teknika operative rreth elementit antiparti. L. B, M. Ç etj ” Niveli i klasifikimit është “Sekret” (7 fletë)
9. **Fondi 4, Viti 1987, Dosja nr. 17**, “**Shënime operative për H. S**”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”.(9 fletë)
10. **Fondi 4, Viti 1973, Dosja nr. 328**, “ Informacione nga hetimi i E. J dhe M. L në drejtim të F. P dhe T. L”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (13 fletë)
11. **Fondi 4, Viti 1986, Dosja nr. 287**, “ Informacione mbi të dënuarit B. B , M. Ç, F. P etj ” Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (110 fletë )
12. **Fondi 4, Viti 1985, Dosja nr. 47**, “ Plan operativ për rrëmbimin e gjashtë personave që mbahen nga Ambasada Italiane”, Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (28 fletë)
13. **Fondi 4, Viti 1986, Dosja nr. 46**, “ Informacione për gjashtë persona me mbiemrin Popa të futur në ambasadën Italiane si agjent” . Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (21 fletë)

14. **Fondi 4, Viti 1986, Dosja nr. 92**, “ Informacione mbi vëllezërit P”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (38 fletë)
15. **Fondi 4, Viti 1988, Dosja nr. 75**, “ Informacione mbi familjen P”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (11 fletë)
16. **Fondi 4, Viti 1989, Dosja nr. 71**, “Informacione nga Ambasada Italiane për gjashtë persona”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (16 fletë)
17. **Fondi 4, Viti 1985, Dosja nr. 345**, “Materiale të H. R, të ardhura nga DPB Burrel”. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. (29 fletë)
18. **Fondi 4, Viti 1983, Dosja nr.319** “Letra e D dhe D. D dërguar udhëheqjes së PPSH-së dhe asaj të MPB-së”. Niveli i klasifikimit “sekret”. (15 fletë)
19. **Dosje formulare nr.61**, kategoria 2/B, në ngarkim të **A. Gj**, në total me 115 (një qind e pesëmbjdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “teper sekret”. Në dokumentet e dosjes përfshihen; lista e dokumenteve, lista e lidhjeve familjare e miqësore, lista e punëtorëve operativë, lista e punëtorëve që implikohen, shënime operative, plan arrestimi, infomacione, fletë kontrolli në kartotekë, vendim, certifikatë familjare, biografia, buletin special, telegram, deklaratë.
20. **Dosje formulare nr.5373/A**, kategoria 2/B, në ngarkim të **R. Ç**, në total me 272 (dy qind e shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “teper sekret”. Në dokumentet e dosjes përfshihen; lista e dokumenteve, lista e lidhjeve familjare e miqësore, lista e punëtorëve operativë, lista e punëtorëve që implikohen, shënime operative, plan arrestimi, infomacione, fletë kontrolli në kartotekë, vendim, certifikatë familjare, biografia, buletin special, telegram, deklaratë.
21. **Dosje formulare nr. 5945**, kategoria 2/B, në ngarkim të **H. R**, në total me 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “teper sekret”. Në dokumentet e dosjes përfshihen; lista e dokumenteve, lista e lidhjeve familjare e miqësore, lista e punëtorëve operativë, lista e punëtorëve që implikohen, shënime operative, plan arrestimi, infomacione, fletë kontrolli në kartotekë, vendim, certifikatë familjare, biografia, buletin special, telegram, deklaratë.
22. **Dosje formulare nr. 5**, kategoria 2/A, në ngarkim të **N. G**, në total me 134 (një qind e tridhjetë e katër ) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “teper sekret”. Në dokumentet e dosjes përfshihen; lista e dokumenteve, lista e lidhjeve familjare e miqësore, lista e punëtorëve operativë, lista e punëtorëve që implikohen, shënime operative, plan arrestimi, infomacione, fletë kontrolli në kartotekë, vendim, certifikatë familjare, biografia, buletin special, telegram, deklaratë.

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

## **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 21, datë 01.10.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 21, datë 01.10.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. **Dosje Personale dhe Pune nr.4144**, pseudonimi “Gjallica”, në ngarkim te **I.A.R.**, me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. **Dosje formulare nr. 1437**, kategoria 2/B, në ngarkim të **A .I. O.** Me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
3. **Dosje formulare nr. 955**, kategoria 2/B, në ngarkim të **Xh. I. S.**, me 40 (dyzetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. **Dosje Përpunimi nr.1755**, kategoria 2/B, në ngarkim të **B. R. B.** me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. **Dosje Përpunimi nr.2394**, kategoria 2/B, në ngarkim të **M. S. M.** me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. Dega e Punëve të Brendëshme Kukës, rregjistër indeksi alfabetik i informatave, model 5, 198 fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

## **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 22, datë 02.10.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të

*klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 22, datë 02.10.2019, si më poshtë:*

### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Kartelë model 2, në ngarkim të shtetasit E.M, kategoria “Informator”, pseudonimi “Përparimi”.
  2. Rreshti i fletës së regjistrit të agjunkturës model K.I nr. 1/1 me 179 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë ku evidentohet nr. rendor 5054.
  3. Rreshti i fletës së regjistrit të agjunkturës pasive ku evidentohet nr. rendor 44 947.
  4. Rreshti i fletës së regjistrit model 2, me 385(treqind e tetëdhjetë e pesë) fletë, ku evidentohet nr. rendor 17 574.
  5. Shkresa nr. 110 Prot, datë 27.09.2019, lënda ; kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor të kërkuar nga Kuvendi i Shqipërisë për 13 (trembëdhjetë) kandidatë për Anëtar në Këshillin Drejtues të RTSH-së.
- 
1. Dosje Përpunimi nr.2394, kategoria 2/B, në ngarkim të M. S. M. me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
  2. Dega e Punëve të Brendëshme Kukës, rregjistër indeksi alfabetik i informatave, model 5, 198 fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 23, datë 03.10.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 23, datë 03.10.2019, si më poshtë:

## **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Fotokopje e Kartelës model model 2, me nr regjistri 1777, në ngarkim të shtetasit A.G, kategoria “informatör”, pseudonimi ”Tigri”.
2. Dosje personale dhe Pune nr. 1007 me 2 volume me 379 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë , në ngarkim të shtetasit N.C me pseudonimin “Globi”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Dosje personale dhe Pune nr. 1564, 3 volume me 446 (katërqind e dyzetë e gjashtë) fletë, në ngarkim të shtetasit F.T me pseudonimin “Vëzhguesi”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
4. Dosje Pune nr.1903 me 605 (gjashtëqind e pesë fletë) në ngarkim të shtetasit N. C me pseudonimin “Alpinisti”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. Dosje personale nr. 2327 me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë, në ngarkim të shtetasit H.L me pseudonimin “ Tomorri”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. Dosje personale dhe Pune nr. 4257 dhe nr. 4077 me 155 (njëqind e pesëdhjetë e pesë) fletë, në ngarkim të shtetasit A.H me pseudonimin “Çelësi”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “ sekret”.
7. Dosje personale dhe Pune nr. 1098 me 3 volume me 377 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë, në ngarkim të shtetasit A.P me pseudonimin “Trëndafil”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Dosje personale dhe pune nr. 4142 me 2 volume me 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë, në ngarkim të Xh.S, me pseudonimin “Gështenja”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. Dosje Personale dhe Pune nr.18, 2 volume me 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. Dosje Personale dhe Pune nr. 14, pseudonimi “Kronometri”, në ngarkim të R. D, me 81 (tetëdhjetë e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
11. Deklasifikim e plotë të shkresës përcjellëse nr. 145 Prot, datë 26.11.2018, me lëndën “Përgjigje e shkresës mbi zbardhjen e pseudonimeve të bashkëpunëtorëve që figurojnë në dosjen e përpunimit të shtetasit Qemal Dema.

### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 24, datë 28.10.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të



*klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 24, datë 28.10.2019, si më poshtë:*

#### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1980, Shtabi, dosja nr.1,** me titull “Detyrat orientuese vjetore të Drejtorisë së Parë dhe përfundimet e analizave vjetore”, 59 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
2. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1981, dosja nr.31,** me titull “Raport vjetor mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Parë dhe detyrat përkatëse”, 44 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
3. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1982, Shtabi, dosja nr.9,** me titull “Raport i analizës vjetore”, 116 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
4. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1982, Shtabi, dosja nr.13,** me titull “Përfundime nga analiza vjetore e Sigurimit”, 30 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
5. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1983, dosja nr.41,** me titull “Analiza vjetore të degëve, ana Sigurimit”, viti 1982, 199 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
6. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1983, dosja nr.45,** me titull “Analizat vjetore të Sigurimit për vitin 1983 sipas rretheve”, 201 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
7. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1983, dosja nr.46,** me titull “Analiza vjetore të degëve”, ana Sigurimit, viti 1983, 147 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
8. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1984, dosja nr.26,** me titull “Raporte e analiza të ardhura nga rrethet”, 470 fletë, niveli i klasifikimit sekret.
9. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1985, shtabi, dosja nr. 13,** me titull “Analiza vjetore të degëve”, 417 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
10. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit Viti 1986, Shtojca, dosja nr. 371,** me titull “Analiza vjetore e degëve të punëve të brendshme, ana e Sigurimit, për vitin 1986”, 342 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
11. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit Viti 1987, Shtabi, dosja nr. 6,** me titull, “Raport vjetor i drejtorisë”, 14 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
12. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit Viti 1987, dosja nr. 91,** me titull “Raporte vjetore të Sigurimit të ardhura nga degët”, 272 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.

13. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit Viti 1989, dosja nr.25**, me titull “Analiza vjetore të sektorëve të Sigurimit të degëve në rrethe”, 276 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
14. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit Viti 1989, dosja nr.26**, me titull “Analiza vjetore të sektorëve të Sigurimit të degëve në rrethe”, 257 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
15. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit Viti 1989, dosja nr. 26/1** me titull “Analiza vjetore të sektorëve të Sigurimit të degëve në rrethe”, 155 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
16. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1985, dosja nr.208**, me titull, “Informacione të ndryshme në lidhje me statistika të detajuara për rrjetin sekret, (27 fletë). Niveli i klasifikimit “sekret”.
17. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1986, dosja nr.148**, me titull “Tabelat statistikore mbi rrjetin sekret e mbi përpunimet ardhur nga rrethet”, 28 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
18. **Fondi nr. 4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1988, dosja nr. 145**, “Pasqyra statistikore të rrjetit sekret dhe të përpunimeve për vitit 1988”, 5 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
19. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1990, dosja nr.283**, me titull “Disa përfundime për punën operative me përpunimet dhe treguesit kryesorë të statistikave të përpunimeve të rrjetit sekret për vitin 1988”, 29 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
20. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1990, dosja nr.284**, me titull, “Disa përfundime për punën operative me përpunimet dhe treguesit kryesorë të statistikave të përpunimeve të rrjetit sekret për gjysmën e dytë të vitit 1989”, 24 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
21. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e Ish- Sigurimit të Shtetit, Viti 1990, dosja nr.285**, me titull, “Disa përfundime për punën operative me përpunimet dhe treguesit kryesorë të statistikave të përpunimeve të rrjetit sekret për vitin 1989”, 15 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
22. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1985, dosja nr. 82**, me titull “Informacion i Drejtorisë së Parë për reagimin e disa Kosovarëve të konstatuara në një person që ka qënë vizitor në Jugosllavi dhe për një të dhënë mbi F. H, dërguar KQ të PPSH e Kryeministrit, 5 fletë. niveli i klasifikimit “sekret”.
23. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1990, dosja nr.319**, me titull “Informacione mbi përmbajtjen e letrave të dërguara nga persona të arratisur e të larguar nga vendi ynë nëpërmjet futjes në ambasadat e huaja”, 17 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.

24. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1991, dosja nr.42**, me titull “Mbi kalimin e paligjshëm të kufirit e për disa tendenca për futjen në ambasada e huaja dhe komente të tjera”, 32 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
25. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1989, dosja nr. 266**, me titull “Për disa reagime të elementeve antiparti L. B, M. Ç etj”, 7 fletë, niveli i klasifikimit “sekret”.
26. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1958, Dosja nr. 61**, “Dosja e objektit ortodoks dhe dokumente mbi veprimtarinë e tij”, 115 fletë. niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
27. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1990, Dosja nr. 560**, “Listat e refugjatëve shqiptarë hyrë në ambasadat e huaja dhe kanë ikur jashtë shtetit”, 48 fletë, “sekret”.
28. **Fondi nr.4, Drejtoria e Parë e ish-Sigurimit të Shtetit, Viti 1990, Dosja nr. 559**, “Informacion për personat që kanë hyrë në ambasadat e huaja, edhe me vërtetime biografike”, 92 fletë, “sekret”.
29. **Fondi 6, Drejtoria e Zbulimit Politik, Viti 1945, dosja nr.1/1**, me titull “Dosje formulare e Mbretit Zog dokumente të periudhës së pasçlirimit si dhe një sasi fotografish e pjesë botimesh në gazeta e revista mbi veprimtarinë e tij”, 91 fletë, niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
30. **Fondi 6, Drejtoria e Zbulimit Politik, Viti 1945, dosja nr.1/2**, me titull “Dosja formulare e Mbretit Zog, dokumente operative mbi veprimtarinë e tij në mërgim derisa vdiq më 1961”, 152 fletë, niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
31. **Fondi 6, Drejtoria e Zbulimit Politik, Viti 1945, dosja nr. 3**, me titull “Fashikull me materiale në ngarkim të F. N”, 76 fletë, niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
32. **Dosje formulare nr.2483**, kategoria 2/A, në ngarkim të **A. B**, në total me 203 fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
33. **Dosje formulare nr.2656**, në ngarkim të **H. M**, në total me 25 fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “teper sekret”.

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

## **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 25, datë 29.10.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe

*Zhvlerësimi të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH*, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 25, datë 29.10.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Deklasifikimin plotësisht të Dosje e Problemit të Centralizuar “Dhelpra” nr. 1160, në ngarkim të A. K. H., A. H. A., A. S. S., E. K. H. dhe P. K. H., me 244 (dyqind e dyzetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
2. Deklasifikimin plotësisht të Dosje e Problemit të Centralizuar “Korbat” nr. 1162, në ngarkim të Familjes P., (M. P., E. P., R. P., P. P., A. P., N. P., I. P., N. P., T. P., E. P., Zh. P.), me 9 volume me 2221 (dymijë e dyqind e njëzetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Deklasifikimin plotësisht të Dosje Objekti nr. 206, në ngarkim të qytetarëve shqiptarë që u larguan nëpërmjet ambasadës gjermane për në RFGJ, me 335 (treqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
4. Deklasifikimin plotësisht të, Dosje Objekti nr. 207, në ngarkim të qytetarëve shqiptarë që u larguan nëpërmjet ambasadës franceze për në Francë, me 232 (dyqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
5. Deklasifikimin plotësisht të Fashikull per futjen e disa personave në ambasadën greke dhe italiane 2 Korrik 1990, me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
6. Deklasifikimin plotësisht të Dosar nr. 1, “Informacione dhe lista të degëve për personat e futur në ambasada”, me 137(njëqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
7. Deklasifikimin pjesërisht të Fletë rregjistri I agjunkturës model 2, të dhënat që i përkasin numrit rendor 3487, në ngarkim të D. I. K., pseudonimi “heshtja”. Niveli i klasifikimit “sekret”.
8. Deklasifikimin pjesërisht të Fletë regjistri “Libri i Fondit Sekret (Fondi I Vecantë)”, të dhënat që i përkasin numrit rendor 7, në ngarkim të L. H. M.. Niveli i klasifikimit “sekret i rëndësisë së vecantë”.

### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 26, datë 31.10.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë

15.11.2017 *“Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 26, datë 31.10.2019, si më poshtë:*

#### **Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, procesverbal nr. 111/16, datë 26.06.1990, mbi dorëzimin e dokumenteve operative të drejtimit. Niveli i klasifikimit “sekret”.
2. Fondi 4, Drejtoria e I-rë, Dega 8, Informacion mbi disa komente nr. 106/46 datë 13.04.1991, fleta nr. 4. Niveli i klasifikimit “sekret”.

#### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

**VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT SHTATOR-TETOR**

**Shqipëria në Rrjetin European të Autoriteteve Zyrtare për Informimin mbi Dokumentet e Policive Sekrete**

**Bratislavë, 24-27 shtator** - AIDSSH mori pjesë në takimin e përvitshëm në nivelit të lartë të Rrjetit European të Autoriteteve Zyrtare për Informimin mbi Dokumentet e Policive Sekrete, i mbajtur në Sllovaki, Bratislavë. Institucioni u përfaqësua nga Kryetarja, znj. Gentiana Sula, Anëtar i Autoritetit, z. Marenglen Kasmi dhe Drejtore e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, znj. Ardita Repishti.

Në takime, AIDSSH, përmes Kryetares Sula, paraqiti kërkesën për t'u anëtarësuar me të drejta të plota në Rrjetin European të Autoriteteve Zyrtare për Informimin mbi Dokumentet e Policive Sekrete, si dhe mori pjesë aktive në veprimtaritë me fokus hulumtimin shkencor dhe edukimin qytetar.

“Sfidat e kërkimit shkencor të AIDSSH, në bashkëpunim me institucionet akademike dhe universitetet” u prezantuan për homologët e Lindjes nga znj. Repishti, me angazhimin për të marrë pjesë dhe kontribuar në aktivitetet e Rrjetit, për të mbajtur gjallë kujtesën e së shkuarës, ku nuk mund të ketë pajtim, pa të vërtetë dhe përkujtim.



### **Fillon rikonstruksioni i ndërtesës së re të Autoritetit, një bashkëpunim mes AIDSSH-së dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë (SIDA)**

**Tiranë, 3 tetor 2019** – Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë (SIDA) zhvilluan në mjediset e reja të Autoritetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, ceremoninë e prezantimit të projektit të bashkëpunimit për rikonstruksionin e ndërtesës së AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkive moderne.

Në praninë e përfaqësuesve të Ambasadës Suedeze dhe të Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë, trupit diplomatik, organizatave ndërkombëtare në kryeqytet, institucioneve publike, qendrore e lokale, shoqatave të drejtave të njeriut dhe të përndjekurve politikë, përfaqësuesve të universiteteve dhe institucioneve kërkimore në vend, përfaqësuesve të institucioneve homologe me të cilat AIDSSH bashkëpunon që prej krijimit, u prezantua projekti i ndërtesës dhe ndërhyrjet e mëdha të pritshme për një godinë me infrastrukturë bashkëkohore e kushte moderne për ofrimin e shërbimeve qytetarëve dhe studiuesve.

Sipas kryetares së Autoritetit, znj. Gentiana Sula: “Qëllimi ynë është krijimi i kushteve optimale me standardet teknike të një arkivi europian, me rëndësi historike për brezat që vijnë, që plotëson edhe kushtet e sigurisë, sipas ligjeve në fuqi... Ndihma e Qeverisë suedeze vjen pas një pune shumë të imët dhe profesionale për hartimin e një projekti të plotë e produktiv që, duke plotësuar këto standarde, synon edhe krijimin e kushteve më të mira për bashkëpunimin me shtresat e

prekura, studiuesit, si dhe qytetarët e grupmohave të ndryshme, të etur për të mësuar përmes formave më bashkëkohore të edukimit historik për demokraci dhe paqe”.

Znj. Elsa Håstad, Ambasadore e Suedisë në Shqipëri theksoi se: “Arkivat duhen për të gjetur të vërtetën mbi të shkuarën dhe për të pajtuar njerëzit me historinë e tyre. Hyrja në materialet arkivore do t’u kthejë njerëzve dinjitetin dhe unë ndihem krenare që vendi im, Suedia, mund të bëhet pjesë e këtij hapi të rëndësishëm”

Bashkëpunimi me SIDA-n në Tiranë zuri fill një vit më parë, pas vizitës në arkivat e institucionit, të partnerëve dhe përfaqësuesve diplomatikë të interesuar të mbështesin drejtësinë tranzicionale në vend dhe shoqatat e të drejtave të njeriut. Kushtet e vështira në të cilat ushtron veprimtarinë e vet Autoriteti, me dy vendruajtje arkivore pranë SHISH e IPQP dhe kushtet e papërshtatshme të ndërtesës ku do të vendoset institucioni që ditë pas dite zbardh të shkuarën, si dhe nevoja për ndërhyrje të mirëmenduara, u bënë pjesë e bisedimeve të vazhdueshme me Ambasadën Suedeze.


Përgjatë një viti të ngarkuar u punua për vendosjen e bashkëpunimit të qëndrueshëm dhe transparent mes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë (SIDA) e AIDSSH, me fokus krijimin e kushteve bashkëkohore të punës, me arkiva të standardeve moderne, zyra pune dhe mjedise për hulumtim shkencor, bibliotekë e sallë ekspozitash.

Ceremonia e shpalljes së këtij bashkëpunimi përmbyll fazën e gjatë përgatitore që u finalizua me marrëveshje dhe u hap dritën jeshile punimeve për rikonstruksionin e ndërtesës, shërbimet TIK për krijimin e një arkive moderne, për të ofruar kushtet e pritshme për kërkim, hulumtim shkencor dhe aktivitete në mbështetje të dialogut shoqëror mes grupmohave të ndryshme, në kuadër të edukimit qytetar e konsolidimit të demokracisë.

Ndërtesa ku Autoriteti do të zhvillojë veprimtarinë e tij iu dha institucionit nga Qeveria shqiptare, me fondet për fazën e parë të sistemimit të arkivit, punime cilësore që janë kryer tashmë. Aktiviteti i parë i institucionit u zhvillua më 25 janar 2017 në këtë ndërtesë, ku arkitektja Nevin Bilali prezantoi për të pranishmit e shumtë qasjen e saj vizive për strehën e re të AIDSSH-së: transparente, të sigurt për arkivin e rëndësishëm, me mjedise pune për studiuesit, me bibliotekë, sallë ekspozitash e dhoma për regjistrimin e dëshmimeve gojore të të mbijetuarve. Ndërkohë, projekti i ndërtesës u realizua nga Instituti i Ndërtimit, me mbikëqyrjen e Autoritetit.

Në vijim, PNUD në Shqipëri kontriboi në mënyrë aktive për hartimin e planit strategjik të AIDSSH-së, ku u përfshi edhe infrastruktura fizike që do të mbështeste veprimtarinë e tij, numerializimi i arkivit dhe ekspertët detajuan çështjet TIK me të cilat u punua më vonë. Partnerë të rëndësishëm e profesionalë e mbështetën AIDSSH-në në këtë rrugëtim.











## **Dokumentari “Edhe muret kanë veshë”, ndërjegjësim për krimet e diktaturës komuniste në Shqipëri**

**Tiranë, 10 tetor 2019** - Dokumentari “Edhe muret kanë veshë” shfaqti premierën e tij në kinema “Millenium”, me titra në gjuhën angleze. Aktiviteti ishte i hapur për mediat, hyrja e lirë.

“Edhe muret kanë veshë” i regjisorit Ervin Kotori ndoqi rrugëtimin e produktit artistik me të njëjtin titull, i realizuar mbi dëshmitë gojore të të mbijetuarve të krimeve të së shkuarës komuniste në Shqipëri, nga Alketa Xhafa Mripa dhe Kristale Ivezaj Rama, në mbështetje të AIDSSH. Të pranishëm në premierë ishin personalitetet e intervistuar në të gjithë vendin, gazetarja shqiptaro-amerikane Kristale Ivezaj Rama dhe artistja konceptuale Alketa Xhafa Mripa, ekipi realizues, studentë e të rinj, përfaqësues të shoqatave të të drejtave të njeriut, trupit diplomatik, të institucioneve publike dhe joqeveritare, të artit, kulturës e medias.

Në hyrje të premierës mbajtën fjalën e tyre kryetarja e AIDSSH, znj. Gentiana Sula, Ambasadori i Italisë në Tiranë, z. Alberto Cutillo, përfaqësuesja e PNUD Shqipëri, znj. Limya Eltayeb, artistja Alketa Xhafa Mripa, gazetarja Kristale Ivezaj Rama dhe regjisorin e dokumentarit Ervin Kotori, para qindra të pranishmëve që mbushnin sallën e kinemasë, mes të cilëve shumë të rinj.

Projekti ambicioz “Edhe muret kanë veshë” u zbatua përgjatë vitit 2018 në të gjithë Shqipërinë në disa përmasa: mbledhja e dëshmimeve gojore, instalacioni artistik, libri dhe platforma e dëshmimeve gojore në gjuhën shqipe e angleze, për t’u finalizuar me filmin që e dokumenton këtë proces, duke hedhur dritë në hapat e ndjekur për zbardhjen e së shkuarës.

Krimet e komunizmit për një kohë shumë të gjatë, rreth 28 vite demokraci, kanë mbetur jashtë vëmendjes së publikut dhe larg çdo qasjeje reflektuese. Mosinteresi shoqëror dhe ndonjëherë

mospranimi i së vërtetës së hidhur të krimeve komuniste është shqetësim real në Shqipëri. Ky qëndrim apatik rrezikon të ketë ndikim te brezat e rinj, ndaj lind nevoja e gjetjes së mjeteve më efikase për transmetimin te brezi i ri i historive të dhunës dhe terrorit të shtetit të diktaturës së proletariatit e mbijetesës së personave të dhunuar.

Për mbledhjen e dëshmimeve gojore në mbarë vendin, AIDSSH vendosi kontakte me shumë persona të mbijetuar dhe dëshmitarë të dhunës e terrorit komunist. U përcaktuan metodat dhe mjetet e nevojshme për mbledhjen e dëshmimeve nga kërkues shkencorë të fushës. Intervistat gjysmë të strukturuar mundësuan shprehjen e lirë të dëshmitarëve, por edhe vjeljen e të dhënave të rëndësishme për ngjarje të caktuara lidhur me krimet në fjalë.

Dëshmitë u zbardhën në zyrat e Autoritetit, ku kryhet administrimi dhe sistemimi me standardin e një arkivi historik, i hapur për cilindo, sipas rregullave të arkivave në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar vullnetin e shprehur të qytetarëve që ua kanë besuar rrëfimet e tyre AIDSSH-së.

Krahas procesit të dokumentimit të dëshmimeve, takimet e hapura në universitete me të rinj e të mbijetuar në të gjithë vendin i paraprinë krijimit konceptual, kompleks e mbresëlënës.

Në prag të Ditës së Europës - 8 Maj 2018, në sheshet kryesore të gjashtë qyteteve: Tiranë, Shkodër, Berat, Korçë, Tepelenë, Gjirokastër, përgjatë gjithë natës deri në agim, u projektua në të njëjtën kohë instalacioni “Edhe muret kanë veshë” i artistes Alketa Xhafa Mripa. Instalacioni është një krijim shumëdimensional i kujtesës kolektive për ata që u dënuan, humbën lirinë apo jetën në burgjet dhe kampet e diktaturës komuniste. Frazat apo thëniet që përshkruajnë tragjedinë njerëzore të shkaktuar nga krimet e komunizmit u shkëputën nga dorëshkrime, dokumente, apo arkiva personale të individëve të burgosur apo internuar dhe u përzgjedhën nga dëshmitë gojore të të mbijetuarve. Shprehjet, dikur të ndaluara, u projektuan në formate të mëdha, në fasadat kryesore të qyteteve, deri në agim duke riafirmuar vlerat europiane, që ishin dhe vizioni i rrëfimitarëve.

E gjitha u realizua në kuadër të programit "Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar", mbështetur nga PNUD Shqipëri dhe Qeveria e Italisë; instalacioni artistik edhe nga Ambasada Amerikane dhe Delegacioni i BE-së në Tiranë.

Përmes artit, projekti i njohu dhe i ftoi për reflektim mbi trashëgiminë e së shkuarës komuniste të rinjtë, komunitetet dhe publikun e gjerë.

Nga ana tjetër, format e komunikimit me publikun e gjerë brenda dhe jashtë vendit u shumëfishuan përmes faqes elektronike “Edhe muret kanë veshë - <http://evenëallshaveears.org/>” e cila, mes të tjerash mundëson pasurimin në vijueshmëri të databazës me dëshmi që i shtohen arkivit të Autoritetit.


Platforma e mbledhjes së dëshmimeve ka mundur të arrijë dëshmitarë jashtë vendit, të cilët janë ftuar të japin dëshmitë e tyre dhe të ndërveprojnë me të. Krahas dëshmimeve të regjistruara janë grumbulluar edhe artefakte si foto të dëshmitarëve, të familjeve të tyre, si dhe fotokopje të dokumenteve që ata kanë në zotërim.

Dëshmitë u dokumentuan në volumnin I “Kampi i Tepelenës. Dëshmitë e të mbijetuarve”, një përmbledhje e dëshmimeve të 14 të mbijetuarve, vuajtës në kampin e internimit të Tepelenës e më pas në kampet e internimit në fshatrat e Lushnjës.

Dëshmitë gojore dhe realizimi i tyre janë filmuar në një dokumentar, në mënyrë që njerëzit ta ndjekin këtë rrugëtim, t'i shohin fytyrat dhe t'i dëgjojnë historitë e shqiptarëve që qëndruan me dinjitet gjatë regjimit totalitar. Dokumentari, veç faktit që hedh dritë në histori, ngjarje dhe individë, i shërben zhvillimit të dialogut të shëndetshëm shoqëror lidhur me të kaluarën, siç i vjen në ndihmë ballafaqimi përmes dokumenteve të vetë shtetit të diktaturës së proletariatit.

Shfaqja e premierës “Edhe muret kanë veshë” përmbyll një fushatë të gjerë, të ndërmarrë nga Autoriteti dhe partnerët për të rritur ndërgjegjësimin për krimet e komunizmit, për të inkurajuar dialog me universitetet, akademikët, komunitetet vendore, të mbijetuarit e familjarët e tyre, mediat dhe publikun e gjerë.











**“Mendimi politik i së majtës”,  
Bashkëpunim i AIDSSH me Fondacionin Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë**

**16 tetor 2019** – AIDSSH zhvilloi në mjediset e veta një takim me studiuesit që do të punojnë për projektin “Mendimi politik i së majtës shqiptare”, që trajton mendimin ndryshe në Shqipëri. Projekti synon të kontribuojë në debatin mbi mendimin politik të së majtës shqiptare dhe trajton 10 profile që u përkasin rrymave të ndryshme të mendimit politik i së majtës.

E majta e sotme në Shqipëri ka si pjesë të trashëgimisë së saj historike jo vetëm luftën antifashiste, por edhe idetë e mendimet e Selaudin Totos, Musine Kokalarit, Gjergj Kokoshit e shumë të majtëve të tjerë që u përpoqën të themelonin një të majtë evropiane. Ndonëse duket sikur është shkruar e folur shumë për këtë pjesë të historisë së Shqipërisë, asnjëherë e majta shqiptare nuk është studiuar në thellësi dhe në të gjithë dimensionin e vet.

Qëllimi i projektit është që, nëpërmjet studimit të disa figurave themelore të së majtës së persekutuar shqiptare, të tregojë të gjitha dimensionet e historisë së të majtës në Shqipëri. Projekti ndihmon brezin më të ri të shqiptarëve për të kuptuar evoluimin e mendimit politik në Shqipëri. Gjithashtu hedh dritë mbi historinë e persekutimit komunist të shqiptarëve me bindje të majta, duke vendosur një gur tjetër në studimet për periudhën e regjimit komunist në Shqipëri.

Projekti i AIDSSH dhe FES finalizohet në 2020, me sesion shkencor mbi profilet e personaliteteve të përzgjedhura, botim të studimeve shkencore, ekspozitë të profileve njerëzore dhe pasqyrim të tyre online në faqen e Autoritetit [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al).







## **AIDSSH në Voskopojë, Korçë e Maliq**

**Korçë, 17-18 tetor 2019** – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një vizitë pune në Voskopojë, Korçë e Maliq, në datat 17-18 tetor, në vijim të bashkëpunimeve me komunitetet brenda dhe jashtë vendit.

Në Voskopojë, përfaqësues të Autoritetit u takuan me z. Vasil Zguri, ish-i burgosur politik për 22 vjet. Sot 97 vjeç, i kthjellët dhe i qartë, Vasil Zguri është njohur me dosjen e tij të përndjekjes dhe ka dhënë dëshminë e vet për sa përjetoi në burg, kalvarin që kaloi familja e tij e internuar në Grabian të Lushnjës dhe izolimin nga të afërmit për sa kohë jetuan në Voskopojë. Në vijim, Autoriteti zhvilloi një mbledhje të zgjeruar të raportimit të veprimtarive të tij gjatë vitit 2019.

Në takimin me përfaqësues të shoqatës së të përndjekurve politikë të Korçës, z. Ylber Merdani, ekipi i Autoritetit vizitoi burgjet e birucat ku u hetuan e u mbajtën të dënuarit politikë që në 1944 e më tej, nga bodrumet e shtëpisë së kthyer në burg të Adem Vilës, tek ish-burgu i madh i Korçës, me hapësirat më vete për gratë e të dënuarit me vdekje, ish-prokuroria, seksionet e nëndheshme të ish-Sigurimit të Këshilli të Qarkut sot, apo ato të rajoni i sotëm.

Në kuadër të bashkëpunimit me pushtetin lokal për zhvillimin e dialogut lokal në Korçë, u zhvilluan takime të frytshme që synojnë të përgatisin organizime komplekse e të qenësishme mbi kujtesën në këtë zonë, duke vënë në qendër historitë e vërteta të përndjekjes, mbijetesës, rezistencës, solidaritetit dhe dinjitetit njerëzor.

Në vijim, ekipi i AIDSSH-së pati takim në Bashkinë e Maliqit, me kryetarin, z. Gëzim Topçiu dhe përfaqësues të departamentit juridik e të kulturës. AIDSSH paraqiti propozimet e veta për bashkëpunime konkrete me pushtetin lokal dhe komunitetin e zonës sa i takon zbardhjes së historive që lidhen me kënetën e Maliqit e atë të Vloçishtit; prezantimin e botimeve të Autoritetit në zonë; identifikimin si vende kujtese të objekteve apo hapësirave që kanë të bëjnë me historinë e errët të komunizmit; verifikimin e figurave që propozohen për tituj nderi, etj.

Një vizitë në terren, të shoqëruar nga përfaqësues të bashkisë dhe të përndjekur në zonë, ndihmoi që të përcaktohen hapat konkretë që do të ndërmerren bashkërisht.













AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

---

Adresa  
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë  
[www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al)